



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2021:174749

Datë: 24.01.2025

Numri i dokumentit: 06755804

ARJ.nr.144/2024

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Delushe Halimi kryetare, Ragip Namani dhe Beshir Islami anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Zanë Buçinca, procesmbajtëse, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit N.T.P “T.” me seli në P., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners”, me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK), me seli në Prishtinë, me bazë juridike anulim i aktit administrativ - vendimit të paditurës nr.01.3.2.2/3149-19 të datës 05.07.2021, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, të paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë në Prishtinë, K.DH.SH.II.nr.843/23, të datës 19.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 22 janar 2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e parashtruar nga paditësi N.T.P “T.” me seli në P., kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë në Prishtinë, K.DH.SH.II.nr.843/23, të datës 19.01.2024.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë në Prishtinë, K.DH.SH.II.nr.843/23, të datës 19.01.2024, është vendosur si në vijim: REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit N.T.P “T.” me seli në P., e datës 15.05.2023, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal, KF.nr.263/2022 të datës 07.04.2023, VËRTETOHET.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë në Prishtinë, K.DH.SH.II.nr.843/23, të datës 19.01.2024, paditësi përmes të autorizuarit të tij, në afat ligjor në këtë gjykatë parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të: shkeljes të së drejtës materiale, me propozim që të: APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe të ANULOHET Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Dytë K.DH.SH.II.nr.843/23, të datës 19.01.2024, dhe Aktgjykimi i Gjykatës

Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal, KF.nr.263/2022 të datës 07.04.2023, dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor nuk ka ushtruar pala e paditur.

Gjykata Supreme, në bazë të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka mbajtur seancën e kolegjit dhe pas vlerësimit të aktgjykimit të atakuar, dhe atij të shkallës së parë, sipas kërkesës së paditësit dhe shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e të paditurës Dogana e Kosovës, nr.01.3.2.2/3149-19 të datës 05.07.2021, është refuzuar si e pabazuar kërkesa e subjektit në procedurë N.T.P “T.”-P., për rishqyrtimin e aktvendimit 03.1.1-2019-96/1 të datës 15.02.2019 të Sektorit të Kontrollit Pas Importues. Në arsyetim të këtij vendimi ndër të tjera theksohet se: E paditura, pasi ka analizuar dokumentet e bashkangjitura dhe ka ardhur në përfundim se subjekti në procedurë nuk ka deklaruar saktë kodin tarifor të mallit me rastin e zhdoganimit të mallit lëndor kontestues, si rezultat i kësaj duke u bazuar edhe në Mendimin për Klasifikimin Tarifor nr.05/10.01.2019, të dhënat nga Sektori i Tarifave, i cili vepron në kuadër të paditurës, ka ardhur në përfundim se paditësi me DUD-at kontestues në rastin e zhdoganimit, nuk i ka deklaruar saktë kodet tarifore të mallit, në rubrikën 33 dhe llogaritjen e taksave në rubrikën 47, ngase mallin e deklaruar për zhdoganim e ka deklaruar me numrin-kodin tarifor 2..., numër ky i cili e ka liruar mallin nga taksa doganore prej 10% dhe TVSH-ja 18% ndërsa sipas Mendimit për Klasifikimin Tarifor, malli është dashur të tarifohet: në numrin tarifor 1..., me përshkrim: “Lëvozhga luledielli në formë pelleti refuz”, sipas të cilit kod tarifor për mallin e deklaruar me DUD-at kontestues duhet të paguhet taksa doganore dhe TVSH-ja.

Kundër vendimit të lartë cekur të paditurës Dogana e Kosovës, paditësi me padi fillon konflikt administrativ.

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin, KF.nr.263/2022 të datës 07.04.2023, ka vendosur si në vijim: I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadija e paditësit N.T.P “T.” me seli në P., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve SCRL Partners, Prishtinë. II. Mbetet në fuqi Aktvendimi i Doganës së Kosovës nr.01.3.2.2/3149-19 i datës 05.07.2021, i Doganës së Kosovës me seli në Prishtinë. III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e saj arsyeton ndër të tjera se: Gjykata e ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit të paditurës për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me vendimin kontestues dhe se dëshmitë e parashtruara nga paditësi nuk kanë ndikim në vendosjen ndryshe në këtë çështje administrative, gjithmonë në rastet kur nuk kemi Informatë Tarifore Detyruese të shtetit eksportues apo të BE-së, për mallin lëndor kontestues. Gjykata konstaton se është i pa bazuar pretendimi i paditësit i deklaruar në padi sipas të cilit numrat tarifor të mallit

lëndor të ndryshuar nga Dogana janë të njëanshme, sepse Sektori për Rishqyrtime, pranë të paditurës në rastet kur nuk ka Informatë Tarifore Detyruese, të shtetit eksportues apo nga Bashkimi Evropian nga paditësi me të drejtë është bazuar në Mendimin për Klasifikimin Tarifor nr. 05/10.01.2019 të dhënë nga Sektori i Tarifave për mallrat identike apo të ngjashme i cili vepron në kuadër të paditurës dhe se Sektori i Tarifës gjatë klasifikimit tarifor është shërbyer me dokumentacionin përcjellës të paditësit për mallrat identike në procedurë gjatë zhdoganimit të mallit, përshkrimin nga fatura, mostrës së mallit identik, raportit të analizave nga laboratorit për mallrat identike, shënimeve sqaruese të sistemit të harmonizuar dhe nomenklaturës së kombinuar kreut 2306 dhe 1213. Gjykata vlerëson se e paditura ka autorizimet e duhura për të ushtruar kontroll, andaj edhe ka vepruar drejtë kur paditësin e ka obliguar me detyrime doganore shtesë për shkak të deklaramit të pa saktë të kodit tarifor për mallin e zhdoganuar përmes DUD-ve kontestues.

Gjykata duke i pasur parasysh dispozitat ligjore të nenit 123 të Udhëzimit Administrativ nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave nr.03/L-109, ku shprehimisht parashihen dokumentet që duhet bashkangjitur deklaratës doganore e ku në mes tjerash në paragrafin 1 pika C thuhet; *“Dokumentet e kërkuara për aplikimin e aranzhimeve preferenciale tarifore dhe masat e tjera që dalin nga rregullat ligjore të zbatueshme për mallrat e deklaruara”*, konstaton se ka qenë obligim i paditësit që në procedurë administrative tek e paditura të ofrojë prova konkrete për të mbështetur kodin tarifor të deklaruar, për vendosje të mallit lëndor në qarkullim të lirë me lirim nga taksa 10 % dhe TVSH-ja 18%, të cilën nga shkresat e lëndës rezulton që paditësi nuk e ka bërë, e sidomos në rastet kur në kodin tarifor të deklaruar sipas TARIK-ut, pra aplikohet lirime nga detyrimet doganore.

Ne referim te nenit 24 par.1 të KDA-së është paraparë që *“Detyrimet e importit për t’u paguar ligjshëmrisht kur lind një borxh doganor, bazohen në nomenklaturën e mallrave të TARIK-ut, Tarifës Doganore të Kosovës, ligjeve të zbatueshme në Kosovë dhe çdo marrëveshje me një vend tjetër apo grup vendesh, ku hyn edhe Kosova kur merren masa për lejimin e trajtimit preferencial tarifor”*, ka vlerësuar se kontrollimi i deklaratave pas zhdoganimit, mund të bëhet bazuar në nenin 82, par.1 të KDA-së, *“Dogana sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të deklaruesit e rishqyrton deklaratën pas liritimit të mallit. 2. Dogana, pasi ta ketë lejuar lirimin e mallrave dhe më qëllim që të sigurohet për të dhënat e vërteta të deklaruara, në deklaratën doganore, mund të kontrollojë dokumentet tregtare dhe të dhënat që kanë të bëjnë me importin apo eksportin, si dhe veprimet pasuese (të mëvonshme) tregtare që kanë të bëjnë me këto mallra. Ky kontroll mund të kryhet në ambientet e deklaruesit ose të çdo personi, drejtpërdrejt ose tërthorazi të përfshirë në veprimet e mësipërme për arsye të veprimtarisë së tij ose të çdo personi tjetër në posedimin e të cilit janë dokumentet e lartë shënuara për qëllime tregtie. Dogana, po ashtu mund të kontrollojë edhe mallrat kur paraqitja e tyre është ende e mundur. 3. Pa rënë ndesh me nenin 219.3 kur nga rishqyrtimi i deklaratës ose kontrollit pas zhdoganimit gjen se dispozitat që rregullojnë procedurën doganore përkatëse janë zbatuar në bazën e të dhënave jo të sakta apo jo të plota, Dogana, në përputhje me dispozitat në fuqi, do të ndërmerr masat e duhura për të rregulluar situatën e krijuar, duke i marrë parasysh edhe informatat e reja që janë në dispozicion”*.

Rrjedhimisht, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se e paditura ka autorizimet e duhura për të ushtruar kontrole andaj edhe ka vepruar drejtë kur paditësin e ka obliguar me detyrime doganore shtesë për shkak të deklarimit të pa saktë të kodit tarifor për mallin e zhdoganuar përmes DUD-ve kontestues. Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 81.I par.2 pika 2.1 të Ligjit nr.04/L-102 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Gjykata Komerciale-Dhomat e shkallës së dytë, me aktgjykimin e kontestuar me kërkesë, duke vendosur sipas ankesës së palës paditëse në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA)-së, nenit 81.H të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222 dhe nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK)-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të saj si më lartë. Në arsyetim pasi bën përshkrimin e gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, bazuar në shkaqet dhe arsyet po ashtu të njëjta, qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e pranon në tërësi si të drejtë dhe ligjor, duke vlerësuar se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe drejtë është aplikuar e drejta materiale me refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit. Në arsyetim të aktgjykimit të saj ndër të tjera ka theksuar se: Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar drejtë ligjshmërinë e aktit përfundimtar të paditurës nr.01.3.2.2/577 të datës 17.10.2018, të atakuar nga paditësi, i cili ka konfirmuar aktvendimin 03.1.1-2019-96/1 të datës 15.02.2019 të lëshuar nga Sektori i Kontrollit Pas Importues. Dogana e Kosovës, drejte ka konstatuar se Sektori i Kontrollës pas Importuese ka vepruar konform dispozitave të nenit 82 të paragrafit 3 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, kur ka ndryshuar Deklaratën Unike Doganore kontestuese duke e obliguar subjektin që të paguaj shumën shtesë në emër të taksave doganore dhe TVSH-së.

Pretendimet ankimore të paditësit sipas shkaqeve ankimore, si dhe theksimet e tjera në përshkrim të ankesës, kolegji i kësaj gjykate i ka refuzuar si të pa bazuara dhe pa ndikim për vendosjen ndryshe të çështjes, pasi që Sektori i Kontrollës Pas Importuese në këtë rast ka konstatuar se subjekti duhet të paguaj obligimet doganore shtesë për mallin lëndor “Bersi Luledielli-Pelletes” me numër tarifor 2., pasi që subjekti me rastin e deklarimit të mallit nuk ka vepruar drejtë kur mallin e ka deklaruar me këtë kod tarifor, pasi që është dashur që malli të klasifikohet në numrin tarifor 1., dhe si rezultat të paguaj taksën doganore prej 10% dhe taksën e TVSH-së, paditësi në këtë rast është dashur që të dëshmojë me prova konkrete siç është në këtë rast informata tarifore detyruese e shtetit eksportues, për të dëshmuar kodin e saktë tarifor të mallit lëndor kontestues. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin kur ka lënë në fuqi aktvendimin e të paditurës, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Andaj, në kuptim të dispozitave nga neni 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Gjykata Supreme duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes si më lartë, vlerësimin të pretendimeve si në kërkesë, ekzaminimit të aktgjykimit të kontestuar dhe të shkallës së parë si dhe shkresave tjera të lëndës, vlerëson se dhomat e shkallës së dytë kanë vendosur drejtë dhe në baza ligjore me refuzimin e ankesës së paditësit dhe vërtetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Qëndrimin juridik të Gjykatës Komerciale në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë meqë aktgjykimet e kontestuara nuk janë të përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës apo të drejtës materiale, ashtu si pretendon pala paditëse në kërkesën e tij. Aktgjykimet e kontestuara përmbajnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje, nga çka rezulton se drejtë është vërtetuar gjendja faktike me refuzimin si të pa bazuar të kërkesëpadisë së paditësit.

Bazuar në provat e administruara për mes shqyrtimit verbal dhe vlerësimin të fakteve, nga gjykatat e instancës më të ulët, ka rezultuar se vendimi i të paditurës Dogana e Kosovës, nr.01.3.2.2/3149-19 të datës 05.07.2021, me të cilin refuzohet kërkesa e subjektit në procedurë, N.T.P “Taka”-Pejë, për rishqyrtimin e aktvendimit nr. 03.1.1-2019-96/1 të datës 15.02.2019, të Sektorit të Kontrollit Pas Importues, është vendim i drejtë dhe i ligjshëm.

Pretendimet e paditësit, të theksuara si në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, përkatësisht referimit në aktgjykimin A.nr.1399/2019, të datës 19.04.2021, sipas së cilit kjo çështje juridike, i ishte kthyer në rivendosje dhe në rishqyrtim të paditurës, për sqarimet shitesë lidhur me atë se mostrat dhe analizat janë bërë mbi bazën e mallit të njëjtë kontestues, si dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Komerciale, të shprehur nëpërmjet aktgjykimit të saj KF.nr.136/22, të datës 06.02.2023., kolegji i Gjykatës Supreme, i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe i refuzoi në tërësi si të pabazuara. Sipas vlerësimin të kolegjit të kësaj gjykate, gjykatat e instancave më të ulëta drejtë kanë vlerësuar, se dokumenti i vetëm kyç që do të mund të provonte pretendimin e paditësit lidhur me klasifikimin tarifor të mallit është Informata Tarifore Detyruese, e lëshuar nga Bashkimi Evropian, aplikuar përshtatshëmrisht siç përcaktohet me nenin 18, të KDA-së, Kodi 03/L-109, e të cilin dokument këtu paditësi ka dështuar ta prezantoj. Andaj, e paditura mbi bazën e autorizimeve ligjore, me të drejtë është bazuar në mendimin e lartcekur të Sektorit të Tarifës, i cili gjatë klasifikimit tarifor është shërbyer me dokumentacionin përcjellës të paditësit për mallrat identike në procedurë gjatë zhdoganimit të mallit, përshkrimin nga fatura, mostrës së mallit identik, raportit të analizave nga laboratorit për mallrat identike, shënimeve sqaruese të sistemit të harmonizuar dhe nomenklaturës së kombinuar kreut 2306 dhe 1213. Ndërsa, referimi i paditësit në praktikën gjyqësore të gjykatës komerciale, nuk e detyron këtë gjykatë në asnjë rast dhe në asnjë rrethanë. Për të garantuar siguri dhe stabilitet juridik, gjykatat më të ulëta zakonisht ndjekin precedentët e krijuar nga Gjykata Supreme.

Edhe sipas vlerësimin të kësaj gjykate, paditësi as pranë organit të administratës dhe as pranë gjykatës, nuk ka arritur që të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar me vendimin kontestues, ndërsa nga dëshmitë e parashtruara nuk ka arritur të dëshmojë se ka deklaruar saktë kodin tarifor të mallit me rastin e zhdoganimit të mallit lëndor kontestues.

I autorizuari i paditësit në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, nuk i është referuar si bazë për parashtrimin e saj shkeljeve të dispozitave të procedurës, prandaj Gjykata Supreme e Kosovës sa i përket kësaj baze është kufizuar vetëm në shkeljet që shikohen sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 215 të LPK-së, me ç'rast ka gjetur se aktgjykimi nuk është i përfshirë në shkelje që kanë të bëjnë me zotësinë për të qenë palë dhe përfaqësimin e rregullt.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykatat e instancave më të ulëta kanë vepruar në baza ligjore me vendosjen e çështjes, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë, i vërtetuar në procedurë ankimore nga gjykata e shkallës së dytë. Nga gjendja si më lartë rezulton se gjykatat e instancave më të ulëta në mënyrë të drejtë kanë bërë aplikimin e dispozitave të LKA, LPK, KDAK-së. Aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta janë të qartë të kuptueshëm dhe përmbajnë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, dhe me të drejtë kanë vlerësuar se nuk është cënuar ligji në dëm të paditësit.

Nga se u theksua si më lartë, e në bazë të nenit 54 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME - PRISHTINË
ARJ.nr.144/2024, më datë 22 janar 2025

B. Profesionale
Zanë Buçinca

Kryetare e Kolegjit
Delushe Halimi